



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 12/2019) dhe nenit 40 Rregullorja e punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit duke vepruar pas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur në vazhdimin e seancës së 50 –të të mbajtur me datë 22.07.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi i dorëzuar me datë 28.07.2020 në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit në bazë të së cilës është formuar lënda me numër 12- 2552/1 nga data 28.07.2020, **REFUZOHET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit nuk elemente për veprimin e saj të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-2552/1 nga data 28.07.2020, për arsye se pas denoncimit tjetre me gjendjen e njëjtë faktike nga i njëjti parashtrues e regjistruar me numër 09-2524/1 nga data 23.04.2019 KSHPK më ka vepruar dhe ka miratuar vendim me numër 09- 1118/1 të datës 14.02.2020.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet vendimi i KSHPKS.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim në formë të depersonalizuar të publikohet në ueb faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12- 2552/1 të datës 28.07.2020 e formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi ----- nga -----.

Në denoncim tregohet për pohime dhe dyshime për paligjshmëri në lidhje me miratimin e aktvendimit për klasifikimin e vendit të punës me titull më të ulët pa procedurë të duhur në Drejtorin e të ardhurave publike, pos pas përdorimit është përdorur për ti kryer punët dhe detyrat nga puna e mëparshme me koeficient më të lartë kompleksiteti, me pagë të titullit më të ulët. Në denoncim theksohet se ka njohuri se udhëheqësi i atëhershëm ----- me vetë

inicativë dërgoi kërkesë për rivendosje në DAP – Drejtoria e përgjithshme Shkup, pa nënshkrim dhe vulë të kërkesës dhe pa qen e arkivume. Me këtë parashtruesi konsideron se udhëheqësi i atëhershëm veproi në kët mënyr për ta punësuar vajzën e tij e cila punonte DAP në dëm të të ardhurave të tij personale gjegjësisht pa e zmadhuar sasinë e pareve për të ardhurat personale të krijon vend pune e cila do të paguhet nga diferenca e asaj nga zvogëlimi i pagave të punësuarave ku në mënyrë joligjore i shpërndau. Sipas kësaj ishte publikuar shpallja publike për dy vende inspektori dhe në at shpallje ishte pranuar -----, vajza e udhëheqësit -----, -----
----- . E gjithë kjo ishte bër në mënyrë jo të drejt, siç theksohet në denoncim për të siguruar fonde për paga dhe pa rritur shumën e parave për paga dhe pa nënshkrimin e ministrit.

Pas shqyrtimit të pohimeve në denoncim, KSHPK konstaton se sipas denoncimit tjetër me gjendjen e njëjtë faktike nga i njëjti parashtrues e regjistruar me numër 09- 2524/1 të datës 23.04.2019 KSHPK tashmë ka vepruar dhe në seancën e 26-të të mbajtur me datë 07.02.2020 miratoi vendimin me numër 09- 1118/1 të datës 14.02.2020, dhe nga këtu konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtutjeshëm, denoncimi të refuzohet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Përgaditi: M.r B.K.SH., Këshilltar
Miratoi: S.P.D., Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska**